



Pranimi / Dorëzuar Priljenaj/Protdata Received/Delivory	12.09.2022	702	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shlyerja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSACK	5327	2022	114	



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.687/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëse, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.687/2022 të datës 03.08.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë

kundër organit të punësimit/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datë 12.09.2022, mori këtë:

### V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.687/2022 e datës 03.08.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. Shfuqizohet Vendimi Nr.190/2022 i datës 01.06.2022, i zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

### A r s y e t i m

Ankuesja ka qenë e punësuar në ish Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale sipas Akt emërimit me numër 240 të datës 16.04.2014 në pozitën “Zyrtare e monitorimit dhe korrigjimit”, në Divizionin e monitorimit të zyrave të pensioneve në Prishtinë.

Me datën 01.06.2022, zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka nxjerrë Vendimin Nr.190/2022, sipas të cilit ankueses i ka përfunduar marrëdhënia e punës me rastin e arritjes së moshës së pensionimit.

Ankuesja e pakënaqur me mos realizimin e kompensimit të tri pagave përcjellëse, me datën 07.07.2022 ka parashtruar ankesën tek Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve lidhur me kompensimin e pagave përcjellëse të pensionit. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publikë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, me datën 18.07.2022, ka nxjerrë Vendimin Nr.Ref.05/2022 sipas të cilit është shpallur jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses, me arsyetimin se e njëjta ka qenë nëpunëse e shërbimit civil.

Ankuesja me datën, me datën 03.08.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 4500/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, me datën 08.08.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve. Këshilli, me datën 10.08.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga kjo ministri së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 4500/2022 të datës 03.08.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërtetimin nga Njësia e Burimeve Njerëzore të MFPT-së lidhur me përvojën e punës së ankueses; Ankesën e ankueses me numër 1484/2022 të datës 12.07.2022 e parashtruar tek Komisioni për shqyrtimin e ankesave në MFPT; Vendimin Nr.Ref.05/2022 të datës 18.07.2022 nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave për nëpunësit e shërbimit publikë në MFPT; Vendimin e datës 30.05.2022 lidhur me të drejtën e njohjes së pensionit bazik; Vendimin Nr.Prot.1217/2022 të datës 06.06.2022 nga zv.Sekretari i Përgjithshëm i MFPT-së lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës së ankueses; Vendimin e datës 30.05.2022 lidhur me njohjen e të drejtës kategorizim për pension kontribut pagues të moshës për ankuesen; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 08.08.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 10.08.2022 nga MFPT-ja lidhur me ankesën e ankueses; Akt emërimit e ankueses me numër Nr.Prot.240 të datës 16.04.2014 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës; Listën e pagave për muajin qershor të vitit 2022 për ankuesen; E-mailin zyrtar të datës 09.09.2022 .

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses

*është e pa bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pranueshmërinë e ankesës dhe afatshmërinë e saj në këshill, ju referua nenit 24 paragrafit 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka përcaktuar se: 3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo

kandidati në një procedurë pranimit në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHC, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative...dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Kolegji konstaton se ankesa e ankueses e parashtruar në Këshill është trajtuar si e afatshme, sepse si rezultat i nxjerrjes së Vendimit Nr.190/2022 të datës 01.06.2022, e njëjta është udhëzuar gabimisht lidhur me këshillën juridike për tek Komisioni i Pranimit brenda Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve e jo në Këshill sipas dispozitës ligjore të lartcekur. Ankuesja edhe pse ka pasur statusin e nëpunësit të shërbimit civil, mbi bazën e këshillës juridike edhe i ka ndjekur procedurat e mëtejme lidhur me realizimin e të drejtës për kompensim fillimisht në komision e pastaj në Këshill. Mbi bazën e këtij konstatimi, Kolegji vlerëson se ankesa e ankueses mbi arsyeshmërinë e këtyre fakteve është e pranueshme në Këshill, duke u bazuar edhe në dispozitat e nenit 127 të Ligjit Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankueses dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014, ka hyrë në fuqi me datën 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhë jo më shumë se tri (3) vjet, respektivisht deri me datën 31.12.2017. Kolegji, po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, me datën 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive pas datës 31.12.2017, kështu që pretendimi ankimor i ankueses lidhur me realizimin e kompensimit të tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, mbi këtë bazë ligjore, është i pa bazuar, sepse ankuesja ka arritur moshën e pensionimit me datën 31.05.2022, në kohën kur nuk ka qenë e aplikueshme Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në konstatimin si me lartë vlerëson se zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.190/2022 të datës 01.06.2022 përmes të cilit ankueses me rastin e pensionimit ia ka njohur të drejtën e kompensimit të një page përcjellëse në vlerën e pagës së fundit, ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 22 paragrafi 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, si dhe dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë, përkatësisht nenin 19 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *"Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën prej një (1) page mujore të njëherëshme në vlerën e pagës së fundit"*. Kështu që Vendimi Nr.190/2022 i datës 01.06.2022 i zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, është nxjerrë në pajtim me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë, me rastin e njohjes se të drejtës lidhur me kompensimin prej një (1) page mujore në



vlerën e pagës së fundit, mirëpo ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjor në fuqi me rastin e dhënies së këshillës juridike, duke e udhëzuar palën ankueses gabimisht për realizimin e të drejtës në kompensim.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbkëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.687/2022, datë 12.09.2022.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dorëzohet:**

- ❖ Ankueses
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Trnasfereve;
- ❖ Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Trnasfereve dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

